



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:257721

Datë: 20.05.2024

Numri i dokumentit: 05709349

KPPP.nr. 1981/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me gjyqtarin Florent Zeqiri, në çështjen përbarimore të kreditorit Rient Sh.P.K., me seli në Prizren, rr. “Ukë Butyqi”, p.n., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Ekrem Agushi, avokat nga Prishtina, kundër debitorit Ronexx Sh.P.K., me seli në Suharekë, me pronar O.H., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve “Vokshi & Lata” me seli në Prishtinë, duke vendosur sipas prapësimit të debitorit ushtruar ndaj Urdhrit Përbarimor P.nr. 669/23, i lejuar më datë 17.10.2023, nga Përbaruesi Privat Bardh Tasholli, me seli në Ferizaj, jashtë seancës, me datë 20.05.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit Ronexx Sh.P.K., me seli në Suharekë, ashtu që Urdhri Përbarimor P.nr. 669/23, i lejuar më datë 17.10.2023, nga Përbaruesi Privat Bardh Tasholli, SHFUQIZOHET.

A r s y e t i m

Përbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, mbi bazën e dokumentit – Faturës nr. 22-SHV01-004-10, e datës 18.03.2020, ka lejuar urdhrin për përbarim P.nr. 212/2022, të datës 30.12.2022, me të cilin është urdhëruar debitori që t’ia paguaj kreditorit shumë prej 20,500.09 EUR, me kamatë ligjore prej 8%, duke filluar nga data 30.12.2022, e deri në pagesën definitive, si shpenzimet e procedurës përbarimore në lartësi prej EUR 312.00.

Debitori, përmes përfaqësuesit të autorizuar, brenda afatit ligjor ka paraqitur prapësim dhe ka theksuar se dokumenti në bazë të së cilit është marr vendimi përbarues ose urdhri përbarues nuk ka titull ekzekutiv ose tipare të përbarueshmërisë. Ka shtuar se borxhin si në propozimin për përbarim e ka përmbushur me rastin e barazimit final me kreditorin meqenëse palët kanë

arritur marrëveshje për të kompensuar njëra tjetrën për furnizimet e bëra gjatë periudhës 2020-2023, ashtu që për furnizimet me material ndërtimor që janë bërë nga ana e debitorit, kreditori në emër të pagesës ta kompensojë me njësi banesore. Tuje, ka theksuar se fatura e cila kërkohet të ekzekutohet është përfshirë në këtë barazim, pasi është lëshuar brenda periudhës 2022-2023, për të cilën kohë janë kompensuar borxhet. I ka propozuar gjykatës që të aprovojë prapësimin e debitorit, ndërsa urdhri përmbartimor të anulohet, si dhe të obligohet kreditori që të kompensojë shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Kreditore, përmes përfaqësuesit të autorizuar, në përgjigje në prapësim ka kundërshtuar prapësimin e debitorit me arsyetim se fatura paraqet dokument të besueshëm dhe i plotëson të gjitha elementet sipas nenit 29 të LPP-së, andaj pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim janë të pa bazuara dhe kanë qëllim zvarritjen e procedurës. I ka propozuar gjykatës që të refuzojë prapësimin e debitorit si të pa bazuar, ndërsa të detyrohet debitor që të kompensojë shpenzimet për përpilimin e përgjigjes në prapësim në vlerë prej 312.00 €.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes së kreditorit në prapësim, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (në tekstin e mëtejshëm: “LPP”) gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbartimor duhet të anulohet, për shkaket si në vijim:

Neni 29, paragrafi 1 i LPP-së, përcakton se: *“Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa, pika 1.3 e njëjtit nen ka përcaktuar faturën si dokument të besueshme sipas të cilit mund të caktohet përmbartimi për realizimin e kërkesës në të holla. Në anën tjetër, me nenin 37 të LPP-së parashihet se: *“Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*

Gjykata, duke ju referuar dispozitave të cekura si më lartë, gjeti se dokumenti, përkatësisht Fatura nr. 22-SHV01-004-10 e datës 18.03.2020, mbi bazën e së cilës është paraqitur propozimi për përmbartim dhe është lejuar urdhri, nuk është deponuar në origjinal apo kopje të vërtetuar siç kërkohet me nenin 37 të LPP-së.

Përkundër kësaj, Përmbartuesi Privat si organ përmbartues në këtë çështje përmbartimore, nuk ka vepruar në përputhje me nenin 38, par.2 të LPP-së me të cilin parashihet se *“Në rast se propozimi për përmbartim nga paragrafin 1. i këtij neni nuk përmban shënime të kërkuara dhe numrin*

*personal identifikues apo numrin e regjistrimit të biznesit të debitorit, organi përmbarues do të veprojë sipas dispozitave të nenit 102 të Ligjit të Procedurës Kontestimore.”*

Në këtë drejtim, referuar nenit 43, par.4 të LPP-së i cili përcakton se “*Në lidhje me ankesën që ngrehë kundërshtimin ndaj urdhrit të përmbarueshmërisë së nxjerrë nga përmbaruesi privat, Gjykata që kryen rishikimin e procedurës së përmbarimit rishikon nëse janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e atij urdhri nga përmbaruesi privat. Nëse Gjykata përcakton se nuk janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e urdhrit për përmbarim nga përmbaruesi privat, Gjykata shfuqizon urdhrin me vendim”* gjykata erdhi në përfundim se urdhri mbi lejimin e përmbarimit është nxjerrë pa u plotësuar kushtet për lejimin e tij, ngase propozimit për përmbarim nuk i është bashkangjitur origjinali apo kopja e vërtetuar e dokumentit përmbarimor. Ndërsa, të metat e lartcekura, nuk mund të evitohen në këtë fazë të procedurës, pasi që gjykata kufizohet vetëm në vlerësimin e shkaqeve të mjetit juridik të prapësimit, dhe jo rregullsisë formale të propozimit për përmbarim.

Gjykata pati parasysh edhe pretendimet e tjera të debitorit të paraqitura në prapësim në raport me të metat e dokumentit mbi bazën e së cilit është lejuar urdhri, mirëpo meqenëse gjykata vlerëson se urdhri për përmbarim është nxjerr pa u plotësuar kushtet për shkak se propozimit nuk i është bashkangjitur dokumenti në origjinal, nuk u lëshuar në vlerësimin e tyre dhe se të njëjtat nuk kanë ndikim në vendosje ndryshe nga gjykata.

Nga sa më sipër, gjykata në mbështetje të nenit 43 dhe 73 të LPP-së, si dhe nenit 13, paragrafi 1, pika 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 1981/23, datë 20.05.2024

Gjyqtari  
Florent Zeqiri

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.